

Deri në gjashtë orë
pritje për shërbime
specialistike në ambulancat
e QKUK-së | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së
SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (13)

UÇK-ja NUK ËSHTË ORGANIZATË TERRORISTE, POR USHTRI QË LUFTON KUNDËR NJË USHTRIE TJETËR

AKTUALE



**NETANYAHU E KRITIKON QËNDRIMIN
E RUSISË PËR GAZËN GJATË NJË
BISEDE ME PUTININ** F. 2

**ZGJEDHJET NË SERBI, OSBE-JA: PËR
ÇASTIN S'KA KUSHTE QË SERBËT TË
VOTOJNË NË KOSOVË** F. 3

**KUSARI-LILA: DRAFTI I
ASOCIACIONIT MUND TË KETË
NDRYSHIME, S'DO TË KRIJOHET
PUSHTET I TRETË QEVERISËS** F. 6

EKONOMI



**INSTITUTI GAP ANALIZON
BUXHETIN PËR VITIN 2024:
FAVORIZOHEN KOMUNAT QË
UDHËHIQEN NGA LV-ja** F. 7

**BE-JA MIRËPRET MARRËVESHJEN
MES KEDS-IT DHE ELEKTROSEVERIT
PËR RRYMËN NË VERI** F. 7



WASHINGTON
SHBA-ja i mbron kontaktet me UÇK-në
**McClenny: "Kemi të bëjmë
me një ushtri e cila lufton
kundër një ushtrie tjetër"**

"UÇK-ja ka ndihmë në terren, ndërsa me bindimet me ata dhe me përkrahjen e tyre në proces, ne mëndohet se po rriten gjatë qe procesi i diplomacisë dhe i negociatave të jetë i suksesshëm". -thi zëdhënësi i State Departmentit, Lee McClenny

Washington, 10 dhjetor. -Shteti i SHBA-së mbështet kontaktet me UÇK-në dhe i mbron kontaktet me UÇK-në. Zëdhënësi i State Departmentit, Lee McClenny, ka thënë se UÇK-ja është një ushtri e cila lufton kundër një ushtrie tjetër. McClenny ka thënë se UÇK-ja ka ndihmë në terren, ndërsa me bindimet me ata dhe me përkrahjen e tyre në proces, ne mëndohet se po rriten gjatë qe procesi i diplomacisë dhe i negociatave të jetë i suksesshëm.

**ra takohet
ë politike**
të jetë në kushtet të kërkesave
i-15" për institucionalizimin
saj.

• e mërkurë • 1.7.2023

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së trembëdhjetë ka folur për koordinimin e

mbështetjes së gjithanshme të UÇK-së, duke përmendur këtu takimet në atë kohë me përfaqësuesit e institucioneve të Shqipërisë. "Gjatë takimit u detajuan modalitetet e ndihmës që shteti shqiptar mund të

jepte për luftën çlirimtare dhe të gjithë u ndamë tepër të kënaqur me gatishmërinë e Qeverisë së Shqipërisë të na ndihmonte në të gjitha aspektet", ka treguar Bardhyl Mahmuti

**TAHIRI: TRI VJET QEVERISJE
NGA KURTI, ASNJË NJOHJE
DHE ASNJË ANËTARËSIM NË
ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE** F. 5



**LDK-ja
ZGJEDH
KRYESINË
E RE** F. 3



KULTURË



**DRITA FITON DERBIN NDAJ
GJILANIT, LLAPI MPOSHTI
BALLKANIN** F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030-500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Luftanija franceze i rrëzon dy dronë që tentuan ta sulmonin nga Jemeni



PARIS, 10 DHJETOR - Një luftanije franceze i ka rrëzuar dy dronë në Detin e Kuq, të cilët ishin lëshuar në drejtim të saj nga bregdeti i Jemenit, tha Ministria e Mbrojtjes e Francës të dielën.

Luftanija Languedoc e kishte vërejtur dhe pastaj shkatërruar dronin e parë rreth orës 21:30 të shtunën,

ndërsa të dytin rreth orës 23:30, rreth 110 kilometra larg bregdetit të Jemenit.

Lëvizja Huthi e Jemenit tha të shtunën se do t'i sulmojë të gjitha anijet që shkojnë në drejtim të Izraelit, pavarësisht kombësisë së tyre, si dhe i paralajmëroi të gjitha kompanitë ndërkombëtare të transportit të mos

bashkëpunojnë me portet izraelite.

Huthi, e mbështetur nga Irani, i ka sulmuar dhe kapur disa anije të ndërlidhura me Izraelin në Detin e Kuq dhe në ngushticën e vet, Baba l-Mandab, një rrugë detare përmes së cilës transportohet shumica e naftës botërore.

Netanyahu e kritikon qëndrimin e Rosisë për Gazën gjatë një bisede me Putinin

JERUSALEM, 10 DHJETOR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, e ka kritikuar Rosisë për qëndrimin e saj në lidhje me luftën në Rripin e Gazës gjatë një bisede telefonike me liderin rus, Vladimir Putin, të dielën, njoftoi zyra e kryeministrit izraelit.

Zyra e Netanyahu tha në një komunikatë për medie se lideri izraelit shprehu pakënaqësinë e tij me qëndrimet që i kanë marrë përfaqësuesit rusë në Kombet e Bashkuara dhe në forumet e tjera ndërkombëtare.

Rusia e mbështeti të premtën një rezolutë të Këshillit të Sigurimit që bënte thirrje për ndaljen e luftës së Izraelit në Gazë, e cila, megjithatë, u bllokua nga Shtetet e Bashkuara që përdorën veto.

Netanyahu, po ashtu, "shprehu kritika të ashpra për bashkëpunimin e rrezikshëm mes Rosisë dhe Iranit", sipas

komunikatës së zyrës së tij.

Izraeli është duke u përballur me kritika dhe thirrje për një armëpushim, sepse i ka vrarë mijëra palestinezë civilë dhe i ka zhvendosur gati 85 për qind të 2.3 milionë banorëve të Gazës brenda territorit të rrethuar ku, sipas OKB-së, nuk ka mbetur me asnjë vend i sigurt për t'u strehuar. "Secili vend që do të goditej nga një sulm kriminal e terrorist siç është goditur Izraeli, do të përgjigjej me po të njëjtën forcë që është duke e përdorur Izraeli", i tha Netanyahu Putinit, sipas njoftimit.

Netanyahu ka shprehur mirënjohje për përkushtimin e Rosisë për lirimin e izraelitëve me pasaportë ruse të cilët po mbaheshin rob nga Hamasi - grupi radikal palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja. Rreth 1 200 njerëz, kryesisht



civilë, u vranë gjatë sulmit të Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor, ndërsa më shumë se 240 të tjerë u morën peng. Gjatë një armëpushimi të përkohshëm njëjavor u liruan një pjesë e pengjeve në këmbim të lirimit të

të burgosurve palestinezë. Megjithatë, besohet se mbi 130 pengje janë duke u mbajtur nga Hamasi në Gazë ende.

Si përgjigje ndaj atij sulmi Izraeli po e kryen një luftë shkatërruese nga toka dhe ajri, duke i vrarë

mbi 17 400 palestinezë - 70 % gra dhe fëmijë - dhe duke i plagosur rreth 46 000, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në territorin palestinez, e cila thotë se shumë njerëz të tjerë kanë mbetur të ngjuar nën rrënoja.

Jordania thotë se Izraeli synon t'i dëbojë palestinezët nga Gaza

AMMAN, 10 DHJETOR - Ministri i Jashtëm i Jordanisë, Ayman Safadi, tha të dielën se Izraeli po e zbaton një politikë për t'i detyruar palestinezët të ikin nga Gaza përmes një lufte që i përputhet "përkufizimit ligjor të gjenocidit". Izraeli i ka hedhur poshtë këto akuza duke i cilësuar "të rrejshme".

Safadi, vendi i të cilit përkufizohet me Bregun Perëndimor dhe i pranoi shumicën e palestinezëve pas krijimit të Izraelit më 1948, theksoi se Izraeli ka mbjellë urrejtje e cila do ta mundojë rajonin dhe përcaktojë gjeneratat e ardhshme.



Izraeli është duke u përballur me kritika dhe thirrje për një armëpushim, sepse i ka vrarë mijëra palestinezë civilë dhe i ka zhvendosur gati 85 për qind të 2.3 milionë banorëve të Gazës brenda territorit të rrethuar ku, sipas OKB-së, nuk ka mbetur me asnjë vend i sigurt për t'u strehuar. "Ajo çfarë po shohim në Gazë nuk është thjesht vrasje e njerëzve të pafajshëm dhe shkatërrim i vendbanimeve të tyre [nga Izraeli], por një përpjekje sistematike për ta zbratur tërë Gazën", tha Safadi në një konferencë në Doha.

Zëdhënësi i Qeverisë së Izraelit, Eylon Levy, i hodhi poshtë akuzat e Jordanisë, duke thënë: "Natyrshisht, këto janë akuza të rrejshme dhe fyese". "Izraeli po lufton për ta mbrojtur veten nga përbindëshat që e kryen masakrën e 7 tetorit, dhe qëllimi i ofensivës sonë është t'i sjellim para drejtësisë këta përbindëshat dhe të sigurohem se ata nuk mund ta lëndojë popullin tonë kurrë më", tha Levy.

Izraeli u ka bërë thirrje civilëve në Gazë të largohen nga fushëbetejat për sigurinë e tyre dhe dëshiron që edhe të tjerët ta përsërisin këtë thirrje, tha Levy.

Gjashtë të vdekur nga stuhia në ShBA

Uashington, 10 dhjetor - Tornadot dhe stuhitë e mëdha e kanë goditur Tenesin të shtunën mbrëma, duke i lënë të vdekur së paku gjashtë

njerëz. Moti ekstrem në disa pjesë të shtetit jugor të Amerikës shkaktoi dëmtimin e ndërtesave dhe ndërprerjen e energjisë elektrike.

Tre njerëz humbën jetën në rrethinën veriore të kryeqytetit të këtij shteti, Nashville. Dy të rritur dhe një fëmijë humbën jetën në qytetin

Klarksville, rreth 80 kilometra në veriperëndim. Njëzet e tre njerëz të tjerë janë lënduar dhe po trajtohen në spital në këtë pjesë të vendit.



Tahiri: Tri vjet qeverisje nga Kurti, asnjë njohje dhe asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie të dielën, ka folur për dështimet e qeverisë dhe mungesën e veprimeve adekuata ndaj çështjeve që prekin direkt mirëqenien e qytetarit. Ai ka theksuar rritjen e kostos së jetës, rezultatin e dobët në PISA dhe dështimet e njëpasnjëshme në politikën e jashtme. "Rritja e kostos së jetës, e çmimeve, energjisë elektrike dhe inflacioni i pakontrollueshëm po cenon standardin e jetës dhe ekonomitë familjare. Pra rritja e kostos së jetës është bërë problem kombëtar. Të punësuarit janë bërë raste sociale e ata të papunët po shkojnë në varfëri të skajshme. Krejt kjo po

ndodh për shkak të realizimit të ulët të buxhetit, 35 % deri në shtator të vitit 2023. Rezultatet në PISA dëshmuar që degradimi i arsimit nuk ka të ndalur i ka lënë nxënësit pa njohuri tradicionale dhe pa njohuri digjitale. Nxënësit tani as nuk shkruajnë dhe as nuk lexojnë mirë, as tradicionalisht as digjitalisht. Asnjë program mësimor që lidh mësimin tradicional me digjital literacy. Asnjë nivel i llogaridhënies për dështim në ofrimin e cilësisë nga askush", ka thënë Tahiri.

Ai ka deklaruar se arroganca ndaj shtresave vitale të shoqërisë dhe injorimi dhe ofendimi i kërkesave ndaj policisë dhe të gjitha sindikatave është bërë trend i kësaj qeverie. "Ajo u pati premtuar qeverisje përmes dialogut social. Tani forma e vetme e komunikimit në vend të dialogut janë fletërrufetë



qortuese kundër kërkesave të tyre legjitime. Qeveri e cila për secilën kërkesë sindikale ka dhjetë kritika qeveritare. Qeveri e cila e ka kapur buxhetin dhe e trajton sikur instrument, me të cilin dëshmon dominimin mbi qytetarët dhe familjet. Asnjë reflektim për rritje të pagave, për përkrahjen e sektorëve me

ndjeshmëri, për investime strategjike. E gjithë energjia e fokusuar në përplasje dhe polarizim, me këdo që kritikon, kundër kujt do që ka ndonjë kërkesë", është shprehur ai. Tahiri ka folur edhe për skandalet në politikën e jashtme. "Diagnoza e politikës së jashtme është: tri vjet asnjë njohje dhe asnjë

anëtarësim në organizata ndërkombëtare, vendi nën sanksione, rroftë Gani Jakupi! Një politikë e jashtme që as nuk i shërben afirmimit ndërkombëtar, as përkrahjes diplomatike të pozitës së Kosovës në dialog, as anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, as afirmimit kulturor apo avancimit ekonomik. Një politikë e jashtme e cila mjaftohet me disa takime kulturore në diasporë dhe as që nuk e ka idenë se si mund të maksimizohet potenciali i diasporës në vendet ku jetojnë dhe as në Kosovë. Politikë e jashtme, e cila fokusin dhe energjitë e saj i ka reduktuar në hapësirat e kabinetit dhe korridoreve të MPJ-së. Diçka thotë ministria sot, krejt diçka tjetër presidentja, e pastaj krejt ndryshe kryeministri", ka thënë Tahiri.

LDK-ja zgjedh kryesinë e re



PRISHTINË, 10 DHJETOR - Në mbledhjen e parë të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së është përmbyllur procesi zgjedhor i kësaj partie, duke zgjedhur kryesinë e re dhe nënkryetarët. "Nëpërmjet zgjedhjes së Kryesisë së re Qendrore, me unanimitet votash e me mbështetje të plotë nga të gjithë anëtarët e këtij Këshilli, përcaktuam dhe fatin tonë vendimmarrës për katër

vitet e ardhshme. Jam i bindur se kjo kryesi, me 16 doktorë shkencash, me 10 magjistra, me kryetarë komunash, deputetë e kryetarë degësh, me veprimtarë të të gjitha gjeneratave, do të shërbejë drejtë, do të shërbejë mbarë, do të shërbejë djathtë, drejt fitores sonë të madhe", ka thënë kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Ai ka thënë se Këshill i

Përgjithshëm i LDK-së vendosi për ndarjen e përgjegjësisë regjionale për secilin anëtar të saj, sikurse dhe nisjen e hartimit të listës së kandidatëve për deputetë që nga tani. "Do të jemi në terren në çdo anë. Do të jemi me qytetarët tanë në Kosovë e në mërgatë. Sepse 'Rruga e re' ka nevojë për secilin prej nesh", ka thënë Abdixhiku.

Kryesia e re e LDK-së:

Kryetar:

Dr. Lumir Abdixhiku

Nënkryetarët:

Anton Quni
Dr. Hykmete Bajrami
Mr. Doarsa Kica Xhelili
Gazmend Muhaxheri
Lutfi Haziri

Sekretarët:

Imri AHMETI, Sekretar i Përgjithshëm
Mr. Sokol HALITI, Sekretar i Degëve Jashtë

Kryetarët e Forumeve:

Dr. Jehona LUSHAKU Sadriu, Forumi i Gruas
Paris Guri, Forumi Rinor

Anëtarët e tjerë të kryesisë:

Dr. Alban Zogaj
Dr. Alush Gashi
Mr. Arben Gashi
Dr. Ardian Shala
Armend Zemaj

Dr. Avdullah Hoti
Mr. Besian Mustafa
Mr. Besnik Osmani
Dr. Berat Rukiqi
Besa Gaxherri
Dr. Bexhet Xheladini
Doruntinë Maloku
Driton Selmanaj
Dr. Ekrem Hyseni
Dr. Ema Nikçi Rexha
Mr. Florian Dushi
Ilir Ferati
Dr. Izet Sadiku
Ak. Kujtim Shala
Lirije Kajtazi
Mirjeta Kalludra
Dr. Muhamet Hamiti
Mr. Ruzhdi Shehu
Rrezarta Krasniqi
Dr. Sibel Halimi
Mr. Shkëmb Manaj
Mr. Visar Azemi
Dr. Visar Berisha
Vlora Dumoshi
Xhafer Gashi
Mr. Xhafer Tahiri

Zgjedhjet në Serbi, OSBE: Për momentin s'ka kushte që serbët të votojnë në Kosovë

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Zgjedhjet në Serbi po afrohen, ndërsa serbët e Kosovës që kanë edhe shtetësi serbe nuk do të mund të votojnë brenda territorit të Kosovës pa një marrëveshje paraprake ndërmjet dy vendeve.

Edhe pse Qeveria e Serbisë ka kërkuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë që të përfshihet në mbledhjen e votave të banorëve të Kosovës me dy shtetësi, për zgjedhjet në Serbi, kjo nuk do të mund të realizohet nëse nuk ka një

marrëveshje të veçantë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Kërkesa për një marrëveshje të tillë duhet të vijë nga Serbia si palë e interesuar", ka deklaruar ditë më parë kryeministri Albin Kurti, duke shtuar se "çdo kërkesë duhet të bazohet në sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës".

Në pyetjen e Radio Kosovës drejtuar misionit të OSBE-së në Kosovë nëse janë të gatshëm për procesin e mbledhjes së votave të



serbëve të Kosovës dhe nëse ka kërkuar nga Qeveria e

Kosovës t'u lejohet serbëve të Kosovës të marrin pjesë në

zgjedhjet e Serbisë, duke votuar brenda vendbanimeve të tyre në Kosovë, në përgjigje thuhet se ky mision ka nevojë për konsensus të të gjitha palëve për këtë çështje. "Misioni, gjithashtu, ka nevojë për mbështetje nga institucionet e Kosovës dhe kryesorja është nevoja për siguri nga Policia e Kosovës, si ofruet i parë i sigurisë. Për momentin këto kushte nuk ekzistojnë", thuhet në përgjigjen e OSBE-së në Prishtinë.



INTERVISTË EKSKLUZIVE me Bardhyl Mahmutin: Si u hoq cilësimi i UÇK-së si “organizatë terroriste”? (13)

UÇK-ja nuk është organizatë terroriste, por ushtri që lufton kundër një ushtrie tjetër

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së trembëdhjetë ka folur për koordinimin e mbështetjes së gjithanshme të UÇK-së, duke përmendur këtu takimet në atë kohë me përfaqësuesit e institucioneve të Shqipërisë. “Gjatë takimit u detajuan modalitetet e ndihmës që shteti shqiptar mund të jepte për luftën çlirimtare dhe të gjithë u ndamë tepër të kënaqur me gatishmërinë e Qeverisë së Shqipërisë të na ndihmonte në të gjitha aspektet”, ka treguar Bardhyl Mahmuti

PRISHTINË, 10 DHJETOR - “Epoka e re”: Kërkesë e vetme e ShBA-së ishte që takimet të mos bëheshin publike nga ana e UÇK-së përpara se një gjë të tillë ta bënin amerikanët. Pas takimit me ambasadorin Robert Gelbard, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Lee Mc Clenny, doli në konferencë për shtyp dhe e konfirmoi takimin që kishit pasur, ndërkaq për takimin me ambasadorin Richard Holbrooke, gjatë

konferencës me gazetarë në Crans Montana të Zvicrës, ai personalisht e konfirmoi se ishte takuar me përfaqësues politikë të UÇK-së. Megjithatë, gjatë gjithë periudhës së luftës nuk doli askush nga ju të sqaronte se kush ishte takuar me diplomatët amerikanë. Kur u kuptua nga anëtarët e tjerë të Kryesisë së LPK-së e vërteta për këto takime?

Bardhyl Mahmuti: Kjo ndodhi gjatë takimeve zyrtare që kishim

me bartësit e institucioneve shtetërore në Shqipëri. Gjatë muajit gusht 1998, në periudhën më të vështirë të ofensivës së forcave serbe, kryetari i LPK-së, Bedri Islami, organizoi takime shumë të rëndësishme me presidentin, me kryeministrin dhe me kryetarin e kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Që të kuptohen rrethanat e asaj kohe, e shoh të rëndësishme ta përmendë faktin se Shqipëria

kishte dalë nga krizat më të rënda që nga koha e shpalljes së pavarësisë. Më 24 janar 1997 shpërtheu një revoltë në Lushnjë, e cila mori karakter të përgjithshëm dhe shndërrua në një luftë civile me pasoja shumë të mëdha (mbi 3 800 persona të vrarë, nga të cilët 360 policë dhe rreth 5000 të plagosur). Si rezultat i kaosit të përgjithshëm që mbretëronte në Shqipëri, më 28 mars 1997 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë për vendosjen e trupave shumëkombëshe në Shqipëri (Misioni Alba), i cili do ta siguronte rendin dhe qetësinë në vend. Rebelimi mori fund më 24 korrik 1997, ndërkaq forcat paqeruajtëse ndërkombëtare u larguan nga Shqipëria më 11 gusht 1997. Me një fjalë, pikërisht në kohën e shpërthimit të luftës çlirimtare në Kosovë, margjina e veprimit të pavarur të shtetit shqiptar ishte tejet e

kufizuar. Për këtë arsye organizimi i takimeve të lartpërmendura ishte e një rëndësie të veçantë, sepse synonte koordinimin e mbështetjes së gjithanshme të UÇK-së.

Pas takimit me presidentin e Shqipërisë, z. Rexhep Mejdani, patëm takim me kryeministrin e Shqipërisë, z. Fatos Nano. Takimi në kryeministri ishte i veçantë, sepse filloi në orën 20:00 dhe zgjati deri në orën 2:00 pas mesnatës. Kryeministri shqiptar shoqërohej nga z. Kastriot Islami, zëvendëskryeministër, z. Vladimir Prella, këshilltari politik dhe nga Perikli Teta, ish-ministër i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë. Për dallim nga takimi me presidentin Mejdani, ku ishin të gjithë anëtarët e Kryesisë së LPK-së, në takim me kryeministrin Nano mungonte Ibrahim Kelmendi, i cili udhëtoi

për në Kinë, dhe Sejdi Gega, për arsye që nuk më kujtohet tani. Në krye të delegacionit ishte udhëheqësi i organizatës, Bedri Islami, dy nënkryetarët (Jashar Salihu dhe unë), Ali Ahmeti, Agush Buja dhe Xhavit Haliti, i cili nuk ishte anëtar i kryesisë, por erdhi si ngarkuar i organizatës për Shqipërinë dhe anëtar i Sektorit të Veçantë të LPK-së.

Disa anëtarë të Kryesisë së organizatës njiheshin personalisht me kryeministrin e Shqipërisë shumë kohë më parë, ndërsa unë e kisha takuar për herë të parë në Crans Montana. Fillimisht z. Nano bëri një përmbledhje të shkurtër të situatës ndërkombëtare në raport me luftën e Kosovës dhe vuri theksin në një klimë më të favorshme për kauzën tonë kombëtare pas ndryshimit të qëndrimit amerikan ndaj luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Megjithatë, këmbënguli disa herë që të ishim maksimalisht të kujdesshëm me qëllim që ndihma që do t'i jepej UÇK-së të mbetej konfidenciale. Në këtë kontekst, Ali Ahmeti iu drejtua miqësisht kryeministrin Nano në formë ankese: "Shoku Fatos, dikush po takohet me diplomatë amerikanë dhe Kryesia e LPK-së nuk është në dijeni as kush e ka përfaqësuar UÇK-në, as çfarë është biseduar gjatë atyre takimeve."

Me të njëjtën gjuhë miqësore ia ktheu edhe kryeministri Nano: "Dëgjo o Abaz Gjuka! Kam lexuar raportet amerikane për ato takime. Të garantoj se as unë, as ti dhe as ne të dy së bashku nuk do ta kishim mundur ta arsyetojmë më mirë luftën e UÇK-së sesa që e ka bërë Bardhyl Mahmuti. Falë atij prezantimi të shkëlqyer të platformës së luftës së armatosur në Kosovë është hequr cilësimi i UÇK-së si organizatë terroriste dhe sot amerikanët e konsiderojnë UÇK-në si ushtri që lufton kundër një ushtrie tjetër. Përndryshe, pa mbështetjen e ShBA-së nuk do të mund të realizonim aspiratat tona kombëtare edhe në rast se të gjithë shqiptarët bëhemi bashkë! Ka të tillë që mendojnë se kjo luftë mund të fitohet edhe nëse Amerikën e kemi kundër! Unë u them prerazi: jo!"

Në këtë rast, kryeministri Nano tha edhe disa romuze që nuk janë për publikun që, megjithatë, kishin për synim tërheqjen e vërejtjes për seriozitetin e qasjes që duhej të kishim. Këtë formë të çuditshme të komunikimi të tij e kuptova më mirë kur doli në publik nga Wikileaks një nga kabllogramet konfidenciale të Ambasadës

Amerikane në Tiranë, në të cilin ambasadorja Mariza Lino përshkruante Fatos Nanos si "serioz edhe kur bën shaka"! Kryeministri Nano nuk e kishte ditur se unë dhe Ramadan Avdi kishim respektuar tërësisht kërkesën e ShBA-së lidhur me konfidencialitetin e takimeve që kishim pasur. U ndjeva në siklet të madh përpara bashkëveprimtarëve që më ishte dashur të mbaja të fshehur disa të dhëna përkundër asaj se kisha besim të plotë te ta.

"Epoka e re": Pasi e mësuan nga kryeministri Nano se ti ishe një nga dy përfaqësuesit e UÇK-së që kishit takuar diplomatët amerikanë, a i njoftove anëtarët e kryesisë me përmbajtjen e këtyre takimeve?

Bardhyl Mahmuti: Jo! Zyrtarisht në të gjitha deklaratimet e zëdhënësve të Departamentit të Shtetit Amerikan dhe të ambasadorit Richard Holbrooke kanë konfirmuar se janë takuar me përfaqësues politikë të UÇK-së dhe kanë kundërshtuar të japin emrat tanë. Unë nuk kam dashur të dalë në publik emri im dhe i Ramadan Avdiut, nga frika se mund ta dëmtonim besueshmërinë në raport me diplomacinë amerikane. Pas përfundimit të luftës, Xhavit Haliti ka folur pak më gjerësisht rreth këtyre takimeve.

"Epoka e re": Si përfundoi takimi me kryeministrin e Shqipërisë, z. Fatos Nano? A arritët ndonjë marrëveshje?

Bardhyl Mahmuti: Gjatë takimit u detajuan modalitetet e ndihmës që shteti shqiptar mund të jepte për luftën çlirimtare dhe të gjithë u ndamë tepër të kënaqur me gatishmërinë e qeverisë së Shqipërisë të na ndihmonte në të gjitha aspektet. Për hollësi më të mëdha rreth rezultateve të këtij takimi mund të njoftoheni nga udhëheqësi i atëhershëm i organizatës, Bedri Islami.

"Epoka e re": Nga momenti kur u takua me Sllobodan Millosheviqin në Samitin e Kretës, z. Nano ka qenë objekt sulmesh të ndryshme mediatike sidomos në Kosovë dhe si rezultat i kësaj fushate është krijuar një opinion negativ ndaj tij. Cili është mendimi juaj?

Bardhyl Mahmuti: Me qëllim të futjes së përçarjes brendashqiptare, takimi i lartpërmendur u problematizua skajshmërisht pikërisht nga mediet e kontrolluara nga ata që nuk linin muaj, për të mos thënë javë, pa shkuar në Beograd për takime publike ose të fshehta me pushtetarët e Serbisë. Z. Fatos Nano ka demantuar disa herë mashtrimet serbe lidhur me përmbajtjen e këtij takimi



dhe është interesant se pikërisht në kohën kur lufta çlirimtare në Kosovë gjeti mbështetjen më të madhe nga shteti shqiptar, propaganda kundër tij u shtua edhe më tepër! Unë jam takuar 4-5 herë me z. Nano dhe ka një çerek shekulli që nuk e kam takuar! Megjithatë ruaj respektin më të madh për këtë burrështetas shqiptar që ka dhënë kontribut jashtëzakonisht të madh për lirinë e Kosovës! Mohimi i kontributit të tij për luftën tonë çlirimtare i ka rrënjët në Beograd. Prandaj ftoj lexuesit e painformuar të mos bienin pre e kësaj propagande dhe, në mënyrë të pavetëdijshme, të bëhen transmetues të sajësive serbe! Populli i Kosovës ua ka borxh mirënjohjen e përrjetshme bartësve të institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe popullit që barti mbi supet e veta një pjesë të madhe të barrës së pasojave të zbatimit të politikës serbe të gjenocidit në Kosovë.

"Epoka e re": Për çfarë arsyesh autoritetet amerikane vazhduan të mbanin emrat tuaj të fshehur

nga publiku edhe pas konfirmimit që ishin takuar me ju?

Bardhyl Mahmuti: Mendoj se një qëndrim i tillë lidhej me çështjen e sigurisë sonë. Po ju tregoj vetëm një rast. Gjatë periudhës së bombardimeve të Serbisë nga NATO kisha paraparë të udhëtoja me kompaninë "Adria" nga Cyrihu në Lubjanë dhe pastaj nga Lubjana në Tiranë. Një natë përpara se të udhëtoja më thirri ambasadori i ShBA-së, Lawrence Rosin, dhe më tha ta anuloja fluturimin për në Tiranë dhe më caktoi një takim urgjent për të nesërme pasdite, në një hotel në afërsi të aeroportit të Gjenevës. Ishte pikërisht ai që përdori fjalën "urgjent" për ta treguar seriozitetin e këtij takimi. U habita si e kishte marrë vesh se do të udhëtoja për në Tiranë. Të nesërmen pasdite, kur u takuam, z. Rosin më njoftoi se Shërbimi Sekret i Serbisë dhe ai i Greqisë ishin në dijeni të udhëtimit tim të paraparë për atë ditë dhe kishin planifikuar ta detyronin aeroplanin të ulej në Selanik, me

arsyetim se nuk mund ta vazhdonte itinerarin për shkaqe sigurie. Shërbimet në fjalë kishin qenë në dijeni që unë posedoja dokument udhëtimi që ma kishin dhënë autoritetet zvicerane në përputhje me konventën e vitit 1951 për refugjatët. Në dokumentin tim të udhëtimit shënohej vendi i origjinës dhe meqenëse Kosova ende konsiderohej pjesë e Jugosllavisë, aty figuronte emri i këtij shteti. Duke u nisur nga fakti se një numër i konsiderueshëm shtetesh, në mesin e të cilëve edhe Greqia, kërkonin viza hyrëse për personat që posedonin dokumente të tilla udhëtimi, ata e kishin menduar të më ekstradonin në Beograd me pretekst se nuk kisha vizë hyrëse për në Greqi. Falë ShBA-së dhe kontakteve që kishim, plani i ekstradimit tim në Serbi dështoi. Kemi edhe raste të tjera kur përfaqësuesit e shtetit amerikanë kanë dëshmuar përkujdesje ndaj nesh dhe familjarëve tanë.

(Muhamet MAVRAJ / Vijon)

Deri në gjashtë orë pritje për shërbime specialiste në ambulancat e QKUK-së

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Pritjet e gjata për të marrë shërbime specialiste në ambulancat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë bërë shumë të mundimshme për qytetarët. Ata janë të obliguar të zgjohen herët dhe të presin me orë të tëra nëpër recepsione dhe, nëse kanë fat, kontrollohen.

Numri i madh i pacientëve në këto klinika, sipas drejtuesve në QKUK, ndodh për shkak të numrit të lartë të rasteve që referohen nga komunat e tjera të Kosovës.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Hamit Hajdari nga Kaçaniku tregoi se ishte zgjuar në orën 05:00 të mëngjesit për të arritur i pari në njërin prej ambulancave specialiste të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë.

Për Hajdarin që udhëtoi rreth 60 kilometra, pritja ishte e gjatë dhe e mundimshme. "Në orën 6:30 na kanë thënë të jemi këtu për t'i marrë numrat. Me vite është ky sistem i punës kështu.

Vjen pacienti pret, siç e shihni edhe vetë. Kjo nuk është në rregull se është një pritje shumë e gjatë e panevojshme", thotë Hajdari. "Nëse arrin ta marrësh numrin herët, kryen punën e pari, nëse vjen me vonesë siç vijnë disa, mbetesh nga ora 6:00 deri në orën 12:00 të ditës", thotë ai. Pacientët duhet të jenë para orës 07:00 në ambulancën e QKUK-së.

Ata duhet ta zënë radhën, në të kundërtën mund të mbesin pa kryer kontrole pasi që mjekët kanë një numër të caktuar të pacientëve që kontrollojnë brenda ndërrimit.

Pas orës 07:30 pjesëtarët e sigurimit i lejojnë pacientët të afrohen pranë sportelit për t'u regjistruar dhe për të marrë një numër, por sërish presin.

Pacientët janë nga qytete të ndryshme të Kosovës.

Me numrin e lartë të pacientëve që referohen këtu, mjekët e kanë të caktuar kohëzgjatjen e një vizite, ajo mund të jetë nga 10 deri në 20 minuta. Por, jo

gjithmonë vijnë edhe mjekët. "Jam zgjuar në orën 05:00, jam përgatitur. Deri në Malishevë kam ardhur... në Malishevë, në 6:10, e kam pasur autobusin dhe kam ardhur këtu, në orën 07:00, në Prishtinë. Kam pritur në radhë, e kam marrë numrin... numrin 6 e kam. Tash pres derisa të vijë mjeku. Besoj se një orë e gjysmë duhet të pres, dy, derisa të vijë mjeku", tregon Idriz Sertolli, i cili kishte udhëtuar nga Malisheva, mbi 40 kilometra larg Prishtinës.

Pritja vazhdon derisa mjekët apo drejtorët e klinikave i kryejnë vizitat e para në klinikat ku punojnë dhe më pas fillojnë punën në ordinancat specialiste. "Kirurgjia plastike dhe stafi i mesëm, edhe mjekët, edhe këta jemi shumë të angazhuar gjatë vizitave ambulatore. Kemi dashur ta zvogëlojmë numrin, por meqenëse është numri i madh, atëherë jemi duke u munduar ta mbajmë standardin evropian, i cili është 17-18

pacientë ambulatorë. Ne kemi shkuar edhe në njëzet, me qëllim që ta rritim, mirëpo po kemi raste që të hënën na rritet numri [i pacientëve] deri në dyzet. Ajo është e pamundshme. Për atë kemi pakënaqësi të palëve", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Agim Berisha, mjek i kirurgjisë plastike.

Drejtori i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Elvi Azizi, thotë se po punohet për lehtësimin e kontroleve të pacientëve në ambulancat specialiste. Ai thotë se shërbimet që ofrohen në ambulancat e QKUK-së duhet të jepen edhe në spitalet rajonale. "Për momentin, jemi duke punuar në dy drejtime. Drejtimi i parë është aspekti organizativ, që nënkupton organizimin e punës duke e ofruar një listë të shërbimeve të garantuara për secilin spital të përgjithshëm regional, ku e përfshijmë edhe QKUK-në", thotë Azizi. Kjo, sipas tij, bëhet

për t'i orientuar pacientët kah spitalet regionale. "Aspekti i dytë me të cilin jemi duke u marrë është aspekti teknik, që nënkupton digjitalizimin e shërbimeve i cili do të na mundësojë një caktim më të mirë të terminëve për pacientët", thotë Azizi.

Në total janë 22 ambulanca të klinikave të ndryshme spitalore të QKUK-së.

Gjatë një dite aty marrin shërbime mbi një mijë pacientë. Në mesin e tyre ishte edhe Hajdari që pas gati katër orësh arriti ta kryente kontrollin për të cilin kishte ardhur. "Po, pas një pritjeje prej tri orësh e gjysmë, katër, arrita në fund ta kryej kontrollin. Është një pritje shumë e gjatë", thotë ai.

Se ka numër të madh të pacientëve në ambulanca specialiste në QKUK e tregojnë edhe të dhënat zyrtare. Nga muaji janar e deri më 20 nëntor, në këto klinika kanë marrë shërbime rreth 220 mijë pacientë.



Kusari-Lila: Drafti i Asociacionit mund të ketë ndryshime, s'do të krijohet pushtet i tretë qeverisës

Prishtinë, 10 dhjetor - Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, është e bindur se drafti i statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, i propozuar nga diplomatët euro-amerikanë, nuk krijon një mekanizëm të ri të pushtetit të tretë qeverisës që mund ta rrezikojë shtetësinë apo kushtetutshmërinë e Kosovës. Megjithatë, ajo thotë se shqetësimet e krerëve të vendit janë në disa aspekte që mund të krijojnë dykuptimësi në zbatim andaj, sipas saj, edhe qeveria ka adresuar komente të ndërmjetësit e dialogut, por për të cilat ende s'ka një përgjigje. Kusari-Lila në një intervistë për

"KosovaPress" përmend mundësinë që drafti të pësojë ndryshime, prandaj shprehet më e rezervuar të komentojë në detaje, mirëpo nënvizon se aleatët e Kosovës, veçmas ShBA-ja ka garantuar se nuk do ta lejojë krijimin një niveli të tretë qeverisës në Kosovë. "Ne nuk flasim për asnjë mekanizëm të ri, qoftë institucional apo në nivel të organizimit të nivelit komunal që mund ta rrezikojë shtetësinë e Kosovës apo kushtetutshmërinë e vendit", ka thënë Kusari-Lila. Shefja e deputetëve e LV-së në Kuvend mirëpret publikimin e draftit të Asociacionit dhe shpërndarjen e tij të partitë opozitare.




Instituti GAP analizon buxhetin për vitin 2024: Favorizohen komunat që udhëhiqen nga LV-ja

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Instituti GAP ka analizuar ndarjet buxhetore për vitin 2024, duke i krahasuar ato me vitin 2023. Sipas analizës së bërë nga instituti GAP, thuhet se në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2024 parashikohet një rritje e ngadalësuar e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, me 5 % dhe 3 % respektivisht, duke arritur në shumën 3 miliardë euro dhe 3.3 miliardë euro. Po ashtu, gjetjet tregojnë se shpenzimet kapitale planifikohen të rriten më shumë sesa ato rrjedhëse, megjithatë rritja e planifikuar e tyre është relativisht e ulët krahasuar me vitin paraprak (15 %). "Te kategoria e pagave dhe shtesave planifikohet të ketë rritje prej 59.9 milionë eurosh apo 8 %, (kryesisht për shkak të rritjes së vlerës monetare të koeficientit të pagave të sektorit publik nga 105 në 110 euro)",

thuhet në raportin e bërë nga instituti GAP. Po ashtu, të gjeturat në raport vënë në dukje se me Projektbuxhetin 2024 është krijuar hapësirë edhe për 2 308 vende pune shtesë, nga të cilat 1 793 për nivelin qendror kryesisht në MPB (polici) dhe FSK si dhe 515 për nivelin komunal. "859.2 milionë euro sa janë planifikuar për shpenzime kapitale, rreth 83 % janë vazhdim i projekteve të mëhershme dhe 17 % janë planifikuar për projekte të reja kapitale. Shkalla e realizimit të buxhetit të ndarë për investime kapitale mbetet e ulët, në nivel 60 % në vitin 2022 dhe në nivel 35 % deri në shtator të vitit 2023", theksohet në raport. Gjithashtu, GAP thotë se edhe këtë vit qeveria ka ndarë më shumë mjete për komunat që udhëhiqen nga LV. "Këtë vit vlera e investimeve kapitale të

reja në komuna është 21.8 milionë euro. Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit qeveria ka ndarë më shumë mjete për komunat e udhëhequra nga Vetëvendosja (LV), ku mbi gjysma e kësaj shume 13 milionë euro (59.5 %) janë orientuar në katër komunat e udhëhequra nga LV-ja (Gjilan, Kamenicë, Podujevë dhe Shtime)". Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kishte njoftuar se buxheti i shtetit për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro. "Do të jetë buxheti i mbrojtjes dhe sigurisë ku kemi ndarë 370 milionë euro ose 22 % më shumë sesa aktualisht. 153 milionë euro për Ministrinë e Mbrojtjes dhe 216 milionë euro për MPB-në", kishte deklaruar ai. Sipas Kurtit, ushtrisë i është rritur buxheti për më shumë se dyfish që kur ai udhëheq qeverinë.



BE-ja mirëpret marrëveshjen mes KEDS-it dhe Elektroserverit për rrymën në veri

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Bashkimi Evropian ka mirëpritur nënshkrimin e kontratës komerciale ndërmjet kompanisë energjetike të Kosovës KEDS dhe kompanisë Elektroserver. BE-ja me anë të një komunikate e ka quajtur këtë hap të rëndësishëm për zbatimin e plotë të udhërrëfyesit për energjinë. "Ky është një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të plotë të udhërrëfyesit për energjinë, për të cilën u ra dakord në qershor 2022 në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE, duke mundësuar zbatimin e Marrëveshjeve për Energjinë të 2013-s dhe 2015-s", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. "Lidhja e kësaj kontrate nënkupton që Elektroserver do ta fillojë furnizimin me energji elektrike për katër komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe. Kjo do t'i jep fund praktikës aktuale



të parregulluar", ka shtuar ai. BE-ja i ka lavdëruar të gjithë të përfshirët që e bënë të mundur dhe "pret që Kosova dhe Serbia ta vazhdojnë me shpejtësi zbatimin e Udhërrëfyesit për Energjinë, si dhe të gjitha

marrëveshjet e tjera të dialogut në interes të normalizimit të marrëdhënieve". Ndërkaq, KEDS-i nëpërmjet një reagimi për medie ka thënë se ky proces i zgatur ka qenë shumë delikat dhe sfidues për

tërë sistemin energjetik në Kosovë. Ndaj ata janë shprehur të kënaqur që "kemi arritur këtë moment historik". "KEDS-i njofton se është nënshkruar kontrata me Elektroserverin, e cila ka për qëllim normalizimin

e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike në komunat Zubin Potok, Leposaviq, Zvečan dhe Mitrovicë Veriore", thuhet në komunikatën për medie. "Kjo kontratë përkon me ligjin e Kosovës dhe kornizën rregullative, në përputhje me Marrëveshjet në lidhje me Energjinë të datës 8 shtator 2013 ('Marrëveshjet e Energjisë 2013') dhe Konkluzionet e Lehtësuesit të BE-së për zbatimin e Marrëveshjes së Energjisë të vitit 2013, të datës 25 gusht 2015 ('Marrëveshjet për Energjinë të vitit 2015'), si dhe Udhërrëfyesin për Zbatimin e Marrëveshjeve Energjetike të 21 qershorit 2022".

Tani KEDS-i ka thënë se pret bashkëpunimin me Elektroserverin, "i cili do të jetë sukses kyç për shërbimet e shpërndarjes dhe investimeve në komunat e lartpërmendura".

Fermerët e dëmtuar në Gjakovë ende pa kompensim


GJAKOVË, 10 DHJETOR - Komuna e Gjakovës në verën e këtij viti ka pësuar dy fatkeqësi natyrore me vërshime, dëmet e të cilave janë vlerësuar të jenë mbi 200 mijë euro. Gjatë muajve qershor-korrik nga reshjet e mëdha të shiut dhe breshëri janë dëmtuar rreth 60 fermerë dhe rreth 80 hektarë tokë bujqësore. Ndërkaq, në Kuvendin Komunal është aprovuar raporti për vlerësimin e dëmeve dhe është dërguar tek

Agjencia e Menaxhimit dhe Emergjencave, më pas do të shqyrtohet nga Komisioni Qendror Qeveritar. Zyrta komunal në Drejtorinë për Bujqësi, njëkohësisht kryetar i Komisionit Vlerësues, Robert Marjakaj, ka thënë se me të dalë në vendin e ngjarjes kanë vlerësuar se dëmi i shkaktuar arrin vlerën prej 239 mijë e 538 eurosh. Vitin 2023 Marjakaj e quan më fatkeqin ndër vite sa i përket motit të

papërshtatshëm për zhvillimin e kulturave bujqësore. Ndër të tjera, Marjakaj ka thënë se nga vërshimet dhe breshëri më së shumti kanë pësuar fermerët e fshatit Rugovë, ngaqë aty kultivohet perim-kultura. Ai shtoi se të prekurit presin dëmshpërblimin nga buxheti Qeverisë e Kosovës, ndërsa potencoi se komuna e Gjakovës nuk ka fond për kompensim të dëmeve në kulturat bujqësore. (ksp)



Át Donat Kurti simbas Át Zef Pllumit



Nga: Sabri HAMITI

Nyja e parë: Cilësimi

“Át Donat Kurti është vjollca e letrave shqipe”. Ky është cilësimi i krijuesit dhe i karakterit të tij, i mbështetur në figurën e vjollcës. “Lulja e përvujtë me një aromë aq të kandshme që rrin e mshefun prej shkurreve e ferrave”.

Vjollca, që nuk bie në sy si zambaku, drandofilja e karanfili, por figuron krijuesin Át Donat Kurti që nuk punon për lavdi, por për të nxjerrë në dritë mendimin estetik, etik e filozofik të shqiptarëve nëpërmjet këngëve dhe përrallave shqiptare. Në këtë vështrim Kurti është krijues letrar dhe kulturor duke shfaqur talentin dhe dijen e vet për të kaluar artin letrar nga gjuha e folur në gjuhën e shkruar.

Nyja e dytë: Gjykimi

Át Zef Pllumi, që “rron vetëm për me tregue”, paraqet dramën e Át Donat Kurtit, kur më 15 janar 1948, në zyrat e “Hyllit të Dritës” në Kuvendin Françeskan që ishte kthyer në një burg të tmerrshëm torturash dhe vdekjesh, ku zhvillohej gjyqi ushtarak kundër dhjetë klerikëve të akuzuar. Mbas kërkesës së prokurorit që do të kërkonte vdekjen e tij, Át Donat Kurti flet: “Mue nuk më bën përshtypje as vdekja as burgu, por më vjen keq se mbeti puna përgjysë. Të gjithë jetën time, të gjithë talentin tim e kam shkruar vetëm për t’i shërbye popullit shqiptar, pa marrë parasysh sakrificat e privacionet”.

Trupi gjykues shtanget, kryetari e ndërpret: “Kur ke luftue ti, çka ke bërë për popullin që po i mburr ato vepra të cilat na nuk i dijmë?”. Át Donat Kurti: “Ásht e kjartë që ju

nuk dini kurrëgjá. Arma ime është penda me të cilën kam mbledhë kangët má të bukura të kombit dhe përrallat má të bukura kombëtare. Po të më jepni vdekjen të gjitha punët mbeten përgjysë”. Át Zef Pllumi dëshmon që trupi gjykues u duk si fëmijët para mësuesit. Për të dëftuar se dënimi ishte me burgim të përjetshëm, që më vonë u shndërrua në 25 vjet.

Nyja e tretë: Dorëshkrimi

Át Zef Pllumi dëshmon se në fondin e dorëshkrimeve që ka lënë Át Donat Kurti figurojnë 37 vepra: fetare, edukative, letrare, gjuhësore, folklorike. Këto dorëshkrime janë ruajtur besnikërisht nga fshatari Mark Hiluku, duke ua ndërruar vendin në fshehtësi për t’i shpëtuar nga syri i spiunëve. Jemi këtu te çështja dramatike e dorëshkrimeve të letërsisë shqipe që për shekuj e vite nuk e kanë parë dritën e botimit dhe çështja po vijonte të ishte fatale edhe për brezat aktualë.

Át Zef Pllumi tregon që nuk ka arritur t’i kalojë nëpër duar gjithë ato vepra, porse vlerëson se tri janë veprat më kryesore të Kurtit: 1. Visaret e kombit, 2. Përralla kombëtare, 3. Testamenti i Ri (dorëshkrimi i pabotuar). Visaret e kombit për kangët e kreshnikëve si dhe legjendat; Përrallat kombëtare, të mbledhura nga populli, mirëpo stili është i Át Donat Kurtit dhe proza shqipe mund të krenohet me to.

Të dyja të vlerësuara si vepra madhore të letërsisë shqipe, por edhe të mënjanuara nga diktatura: “Mjerisht nga inati sektar për gegnishten si edhe lufta e vazhdueshme që u bahej viryeteve të lashta të Besës e Burnis”. Ende Át Zef Pllumi ka

parasysh stilin, veprën krijuese të mjeshtrit të krijimtarisë letrare shqipe, kur vepra kanonike popullore merr domosdo ngjyrën e autorit në aktin e kulturës me shkrim.

Nyja e katërt: Testamenti i Ri

Këtë vepër kanonike të krishterimit Át Donat Kurti e ka përkthyer nga latinishtja në shqip, në burgun e Burrelit gjatë katërmëdhjetë vjetëve të qëndrimit aty, tekst i cili në plot kulturë është bërë themel i gjuhës së tyre të shkruar. Át Zef Pllumi për këtë situatë saktëson: “Ásht një histori po si ajo e katakombeve”.

Është i vetmi libër që kishte hyrë disi, tinëz, në burgun e Burrelit. Përkthyesi nuk e dorëzoi kurrë librin, por me të tjerë e fshehu edhe nën kapakët e librave të Leninit. Fletët e përkthimit janë ruajtur për shumë vite dhe janë nxjerrë fshehtas nga burgu. Pas lirimit nga burgu, përkthyesi ende nuk ishte i kënaqur me përkthimin e vet të bërë në rrethana të jashtëzakonshme dhe vijoi punën për përmirësimin e tij, për të cilin Át Zef Pllumi shton: “Pa dyshim mund të thom se ky është përkthimi má i miri në gjuhën shqipe deri tash”.

Nyja e pestë: Proza gege

Át Zef Pllumi ngulmon që kur të botohet ky përkthim, “do të konsiderohet si proza má e bukur letrare e gegnishtes gjatë këtyne vjetëve”, po ashtu vonësën e botimit të përkthimit e lidhë edhe me pengesat e klerit katolik kosovar, që nëpërmjet autoriteteve të Vatikanit e kanë penguar që të përdorej gjuha shqipe gege ndër libra fetarë.

Shkurt dhe këput, Át Zefi don të shprehë mjegullnajat politiko-fetare, që prekin çështje të idiomës letrare qoftë dhe në libra kanonikë.

Në anën tjetër, ai shtron dhe çështjen e drejtë të domosdosë së përdorimit të idiomës, veçanërisht në tekstet në prozë. Këtu ai në mënyrë fine thekson se çështja e statusit të idiomës letrare provohet para së gjithash në prozë. Venerimet e tij shohin edhe më larg, prandaj kanë në brendësi dhe vlerësimet e kësaj gjinie në sistemin e letërsisë së shkruar, e cila po ashtu duket krejt e një niveli tjetër po të kihen parasysh shkrimet në prozë të rrethit kulturor të françeskanëve shqiptarë.

Nyja e gjashtë: Françeskani i madh

Duke ndjekur logjikën e tillë të vlerësimit, Át Zef Pllumi, Át Donat Kurtin që lindi në Shkodër, në vjetin 1903 e bën pjesë të dymbëdhjetëshes të qendrës më të rëndësishme të intelektualëve në historinë e kulturës shqiptare, nën drejtimin e Át Gjergj Fishtës, ku i vë në rend Át Pashk Bardhin, Át Shtjefën Gjeçovin, Át Pal Dodajn, Át Vinçenc Prenushin, Át Marin Sirdanin, Át Anton Harapin, Át Justin Rrota, Át Bernardin Palajn, Át Benedikt Demën, Át Athanas Gegajn deri tek Át Gjon Shllaku.

Është e natyrshme që dijetari Át Zef Pllumi në panteonin kulturor shqiptar sheh edhe françeskanë të tjerë, më të hershëm apo më të vonshëm, mirëpo është korrekt me vetveten sepse këtu flet me kujtesë dhe dëshmi, në radhë të parë për njerëzit që i ka njohur vetë. Prandaj, në panteonin e tij të kulturës shqipe hyjnë si

njerëz shembullorë shqiptarë dhe tëhuaj si: Norbert Jokl, Eqrem Çabej, Lazër Shantoja, Krist Maloki, Filip Fishta, etj..

Nyja e shtatë: Rrno vetëm për me tregue

Át Zef Pllumi shkrimin e vet për Át Donat Kurtin, të vitit 1993, e përfundon: “Kishem me pasë shumë e shumë për të shkruar mbi Át Donatin. Sot na mbetet detyrë të bëjmë përpjekje me nxjerrë edhe një herë prej podrumesh, ku i kanë përplasë këta autorë, me i shpluhnosë me ia dhënë në dorë rinisë që të vazhdojnë veprën e tyre të madhe për dobí të popullit shqiptar”.

Një pjesë e testamentit kulturor të Át Zef Pllumit tani realizohet me botimin e veprave (edhe në dorëshkrim) të Át Donat Kurtit në kolanën e botimeve françeskane, të cilën Át Zefi e kishte rinisur për të gjallë të vetë. Edhe ai vetë ishte përjetësisht i pushtuar nga malli për të shkruar dhe për të dëshmuar. Këtë arriti ta bënte me shkrime humaniste, autobiografike, dëshmuar, prohistorike dhe letrare. Dëshmia më e mirë është vepra e tij kapitale “Rrno vetëm për me tregue”, që lidhë dy shekuj të letërsisë shqipe. Vepër tashmë e kurorëzuar si një nga kryeveprat letrare në prozë gegnishte.

E përkthyer në gjuhët e mëdha europiane, vepra është çmuar si ligjërimit fundamental i letërsisë së burgut e llogorit, e dëshmuar në botën shqiptare. Át Zef Pllumi, le të na lejohet të themi sot e këtu, për ne, është Françeskani i Madh. Prandaj veprat e tij, që janë ende në dorëshkrim duhet të botohen në mënyrë integrale, pa asfarë shkurtimi.

Cirku i Medias: Kur ndodhi që e humbëm fare arsyen dhe ndjeshmërinë?

... Dua të ndihmoj për rritjen e ndjeshmërisë së një kulture, që besoj fort që është bërë, ndonjëherë, totalisht e mpirë ndaj dhimbjes së të tjerëve, duke kontribuar në një ndjenjë të përgjithshme apatie ndaj njëritjetrit.

Kam parë me sytë e mi negativitetin, urrejtjen dhe armiqësinë që mund të fermentohen në Internet për shkak të mungesës së mirëkuptimit dhe dhembshurisë – një shkëputje totale mes një titulli dhe një familjeje që qëndron prapa tij. Cikli 24-orësh i lajmeve krijon një nevojë për përmbajtje që mund t'i shtyjë njerëzit e medias që ndonjëherë të veprojnë me papërgjegjshmëri në raportimin e tyre, për shkak se janë duke konkurruar me gazetarët amatorë që shfaqen aty-këtu nëpër blogje, në çdo qoshe të internetit. Ai krijon gjithashtu një ndjesi të rremë lidhjeje. Breshëria konstante dhe përsëritja e pafundme e informacionit krijojnë iluzionin se mund të kesh qasje tek cilido dhe tek gjithçka, në çast, sa hap e mbyll sytë. Dhe ndonjëse tragjeditë që media ndan me ne lexuesit dhe shikuesit nuk na kanë ndodhur ne, ne i marrim



sikur kështu është – humbjen, zemërimin, dashurinë, padrejtësinë. Ne e ndjejmë thellësisht. Dhe pastaj, ja ashtu sa hap e mbyll sytë, kalojmë tek lajmi tjetër, duke lënë pas një familje të trazuar. A e kemi ngatërruar vijën ndarëse mes “të drejtës së

publikut për t'u informuar” dhe dhunimit të privatisë? A kemi mbërritur deri aty sa të besojmë se, vetëm për shkak se një lajm na ka dalë në facebook apo instagram, ne jemi të detyruar ta ndajmë, të komentojmë, të pëlqejmë, ta ripostojmë? A e pyesim ndonjëherë veten pse e

bëjmë këtë? Dhe kë po prekim kur e bëjmë?

Mënyra se si media zbret në një familje të ndjerë në krizë mund t'ua rrëmbejë atyre pikëllimin. Katapultimi i një familjeje, në zi, para kamerave mund të jetë mizor dhe dhunues. Por ndonjëherë mizoria më e madhe

qëndron në pasojat e vazhdueshme të informacionit të pasaktë, thashethemeve për të vdekurit dhe supozimeve dhe debateve që ato ndezin. / Shkëputur nga libri i Kim Goldman “Cirku i Medias: Një vështrim mbi tragjeditë private në sytë e publikut” (bota.al)

Magjia e një audience

Mendojeni pak: kur shikoni një film, apo një pjesë në teatër, apo edhe ndonjë lloj tjetër performance bashkë me njerëz të tjerë, si pjesë e një audience, eksperiencia që keni është shumë e ndryshme, në krahasim me kur e shikoni vetëm.

Për shembull, mund të shikoni një komedi në një kinema, dhe mund të mbani barkun me dorë nga të qeshurat bashkë me pjesën tjetër të të pranishmëve, por kur e shikoni po atë film vetëm, në dhomën tuaj të ndenies, është pothuajse e sigurt që nuk do të qeshësh aq shumë. Të qënit pjesë e një audience i ndryshon gjërat, ajo është në vetvete një eksperiencë.

Po çfarë kanë kaq magjike audiencat, si ndodhi që dikujt i erdhi në mendje ideja për të bërë bashkë njerëzit në një grup, për të parë diçka. Dhe si pjesëtarët e audiencës mesuan se çfarë të bënin kur e shihnin? Audiencia nuk është e pranishme në një performancë thjesht për ta parë, por ajo është pjesë e saj. “A keni qenë ndonjëherë në një shfaqje apo një film. Thonë diçka për të qeshur, dhe e gjithë audiencia qesh. Ti nuk qesh, sepse mendon që ‘nuk e kuptova’. Por pas një sekonde, ti e kupton. Është audiencia që të ka thënë se ajo gjithë është për të qeshur, dhe kështu ti e mbledh atë lloj energjie”, thotë Robert



Viagas, autor i librit “Një histori e audiencës”.

“Ose ka njerëz që paguajnë qindra e qindra dollarë për të parë në koncert Teilor Suift”, vazhdon ai. “Ata mund të rrijnë në shtëpi, të shikojnë video, mund të dëgjojnë albumet e saj, por ata ndjejnë që ekziston një lloj elektriciteti special që ata e përjetojnë vetëm kur janë bashkë me fansa të tjerë të këngëtares”.

Stephen King ka shkruajtur një libër shumë interesant, ku shpjegon përse njerëzit shikojnë në kinema për të parë filma

horror. Sipas tij, “njerëzit shikojnë për t'u matur përkundrejt asaj që shohin. Pyesin veten nëse janë mjaftueshëm të fortë për ta përballuar atë film. Shikojnë e shohin filmin, shohin skena të tmerrshme vrasjeje për shembull, por mendojnë që ia kanë dalë t'i mbijetojnë duke e parë”.

Historia

Audiencave u është dashur që të trajnohen përgjatë historisë, u është dashur të mësojnë se si të jenë të tilla, pra audiencia. Në

kohën e grekëve të lashtë, ata e dashuronin poezinë, ata thërrisnin poetë që vinin dhe recitonin në skenë. Shumica e poezive të tyre ishte për perënditë e kohës. Ata u bënë kaq popullorë dhe ndonjëherë thërrisnin dy, tre apo edhe katër njerëz, që ata e quanin kor. Të gjithë ata e recitonin poezinë në mënyrë të njkohëshme. Dhe audiencat e pëlqenin pa masë këtë, teksa dëgjonin rrëfimet poetike “Zeusi bëri këtë, apo Zeusi bëri atë”.

Dhe një ditë, një personazh nga kori, i cili quhej Thespi, bëri

diçka radikale. Ai bëri dy tre hapa përpara korit, dhe në vend të thoshte “Zeusi bëri këtë, apo Zeusi bëri atë”, ai tha “Unë jam Zeusi! Ja çfarë bëra unë!”. Audiencia në fillim u shokua. “Ai nuk është Zeusi! Ai nuk ngjan si Zeusi, ai ngjan si Thespi”. Por pak e nga pak, audiencia nisi të mendojë: “Shiko, unë nuk e di si e ka zërin Zeusi, por vë bast që kështu duhet ta ketë. Mendoj që Thespi po bën një punë të mirë”. Dhe kështu, audiencat nisën të pranojnë se një person në skenë mund të mishërojë një personazh tjetër.

'Skifterët e Vdekjes', kush janë 10 snajperistët më të fortë të historisë së njerëzimit



Snajperistët kanë qenë një komponent thelbësor i strategjisë ushtarake, pasi me aftësinë e tyre mund të eliminojnë trupat kundërshtarë nga një distancë e madhe dhe të depërtojnë në linjat e padukshme të armikut. Ekipet e snajperistëve (nga Lufta e Parë Botërore e deri më sot) kanë dëshmuar vazhdimisht aftësinë e tyre për t'u shkaktuar dëme masive forcave kundërshtarë. Sidoqoftë, si me të gjithë luftëtarët, disa snajperistë janë dalluar nga të tjerët me aftësitë e tyre.

POR KUSH JANË SNAJPERISTËT MË TË NJOHUR NË HISTORI DHE SA ËSHTË REKORDI I TYRE PËRGJATË OPERIMIT?

10- Chuck Mawhinney

Charles Benjamin "Chuck" Mawhinney ishte një ish-marins i Shteteve të Bashkuara të Amerikës që shërbeu 16 muaj në ushtri gjatë Luftës së Vietnamit. Si snajperist, rekordi i vrasjeve që ka kryer Mawhinney vlerësohet të jetë 103, sipas numrit të konfirmuar (një rekord i Korpusit Detar), derisa 216 vlerësohet të jetë numri i pakonfirmuar i vrasjeve. Mawhinney ishte djali i një veterani të Trupave Detare nga Lufta e Dytë Botërore dhe iu bashkua marinsave pasi mbaroi shkollën e mesme në vitin 1967.

9- Adelbert Waldron

Adelbert F. "Bert" Waldron III ishte një ish-snajperist i Ushtrisë

së Shteteve të Bashkuara që shërbeu me Divizionin e 9-të të Këmbësorisë gjatë Luftës së Vietnamit. Para se të shërbente në ushtri, Waldron shërbeu afërsisht 12 vjet në Marinën e SHBA-së. Pas transferimit në ushtri, ai u caktua tek anijet patrulluese (PBR) për të monitoruar Deltën Mekong në Vietnam. Në më pak se tetë muaj, Waldron kishte vrrarë 109 trupa të forcave kundërshtarë.

8- Henry Norwest

Henry "Ducky" Norwest ishte një snajperist kanadez i njohur për bëmat e tij në Luftën e Parë Botërore. I lindur në Fort Saskatchewan, Alberta, më 1 maj të vitit 1884, Norwest punoi si një fermer, interpretues rodeo dhe përfundimisht në policinë mbretërore veriperëndimore përpara se të bashkohej me ushtrinë kanadeze në vitin 1915. Edhe pse fillimisht u shkarkua për sjellje të pahijshme vetëm tre muaj në karrierën e tij ushtarake, ai më vonë u rivendos në ushtri me një emër tjetër dhe u caktua në Batalionin e 50-të Kanadez të Këmbësorisë. Në më pak se tre vjet, Norwest kishte kryer 115 vrasje.

7-Chris Kyle

Christopher Scott Kyle ishte një snajperist i Marinës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës i cili shërbeu katër herë në Irak. Kyle lindi në Odessa, Teksas, më 8 prill të vitit 1974 nga Wayne dhe Deby Lynn Kyle. Pasi punoi si fermer, kalorës profesionist i rodeos, Kyle

më vonë iu bashkua njësisë SEAL të Marinës së Shteteve të Bashkuara pasi vuajti nga një lëndim që i dha fund karrierës gjatë kohës së tij si kalorës rodeo. Pasi iu nënshtrua një operacioni për të shëruar krahun e tij, Kyle mori një ftesë për një trajnim Bazik Nënutor (BUD/S) dhe për trajnim në njësinë SEAL (Det, Ajër, Tokë) në Coronado, Kaliforni (1999). Më vonë u caktua në elementin e snajperistëve të SEAL Team-3, Kyle shpejt u gjend mes disa veprimeve intensive në të gjithë Irakun. Gjatë katër shërbimeve, Chris Kyle kishte 160 vrasje të konfirmuara në të gjithë Irakun në zona të tilla si Ramadi, Falluxha dhe Bagdad.

Vasily Grigoryevich Zaytsev ishte një snajperist sovjetik që shërbeu në Ushtrinë e Kuqe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai vlerësohet me mbi 242 vrasje të konfirmuara. I lindur në Yeleninskoye, më 23 mars 1915, Zaytsev thuhet se e mësoi gjuajtjen e tij nga gjyshi i tij në malet Ural. Pas mbarimit të kolegjit dhe punës së shkurtër në ndërtim, Zaytsev më vonë u regjistrua në ushtrinë sovjetike, duke shërbyer në Flotën e Paqësorit (duke filluar në vitin 1937).

Lyudmila Mikhailovna Pavlichenko ishte një snajperiste sovjetike që shërbeu me Ushtrinë e Kuqe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo vlerësohet me 309 vrasje të konfirmuara gjatë karrierës së saj ushtarake. E lindur në "Bila Tserkva" (Ukraina e sotme) më 12 korrik të vitit 1916, Pavlichenko më vonë u zhvendos me familjen e saj në Kiev, ku

punoi në fabrikën e Arsenalit të Kievit. Në kohën e saj të lirë, Pavlichenko zhvilloi një interes të madh për gjuatje dhe madje u bashkua me një klub lokal ku i zhvilloi aftësitë e saj si gjuajtëse e mprehtë.

Deri më sot, Pavlichenko mbetet një nga snajperistët më të forta në historinë moderne dhe konsiderohet si snajperistja më e suksesshme femër e të gjitha kohërave. Ajo vlerësohet se ka vrrarë 257 ushtarë të Gjermanisë naziste, përfshirë 36 snajperistë.

4- Carlos Hathcock

Carlos Norman Hathcock II ishte një snajperist i Trupave Detare të Shteteve të Bashkuara që shërbeu gjatë Luftës së Vietnamit dhe vlerësohet me 93 vrasje të konfirmuara. I lindur në Little Rock, Arkansas, më 20 maj 1942, Hathcock kishte njohuri për gjuajtje që në moshë të re, pasi familja e tij mbështetej shumë në gjueti për t'u ushqyer.

3- Francis Pagahmagabow

Francis Pagahmagabow ishte një snajperist në Luftën e Parë Botërore. Ai vlerësohet për 378 vrasje të konfirmuara. Ai lindi në Rezervën e Kombit të Parë Shawanaga në Nobel, Ontario, më 9 mars të vitit 1891. Pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, Pagahmagabow doli vullnetar për shërbimi ushtarak dhe u caktua në Forcën Kanadeze të Ekspeditës në vitin 1914 (dhe më vonë u ricaktua në Regjimentin e 23-të Kanadez).

Fyodor Okhlopov ishte një snajperist sovjetik që shërbeu me Ushtrinë e Kuqe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai vlerësohet me 429 vrasje të konfirmuara gjatë karrierës së tij.

I lindur më 2 mars 1908 në fshatin Krest-Khaldzhay, Rusi, Okhlopov ishte me përkatësi etnike yakute nga sektorët e Lindjes së Largët të Bashkimit Sovjetik. Megjithëse dihet pak për Okhlopov (për shkak të mungesës së të dhënave në lidhje me jetën e tij), besohet se ai fillimisht u bashkua me Ushtrinë e Kuqe me vëllain e tij, i cili më vonë u vra në luftime.

1- Simo Hayha

Simo "Simuna" Hayha ishte një snajperist finlandez që shërbeu në Luftën e Dimrit të viteve 1939-1940 dhe vlerësohet me 505 vrasje të konfirmuara kundër ushtarëve të Ushtrisë së Kuqe. I lindur në Rautjarvi, Provinca Viipuri, Finlandë, më 17 dhjetor të vitit 1905 në një familje fermerësh, Hayha më vonë iu bashkua Milicisë Vullnetare Finlandeze (e njohur si "Garda e Bardhë") në moshën njëzet e një vjeçare. Duke përdorur aftësitë e zhvilluara fillimisht në rininë e tij nga ekspeditat e gjuetisë me babanë e tij, Hayha konkurroi në gara të shumta qitjeje në të gjithë Provincën Viipuri, duke fituar trofe të shumta për aftësitë e tij të gjuajtjes së mprehtë. Me shpërthimin e luftës midis Finlandës dhe Bashkimit Sovjetik në vitin 1939, Hayha shërbeu si snajperist gjatë Betejës së Kollaa-s.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Drita fiton derbin ndaj Gjilanit, Llapi mposhti Ballkanin

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Skuadra e Dritës e ka fituar derbin e Anamoravës ndaj Gjilanit me rezultat minimal 1-0. Kjo ndeshje i ka takuar javës së 17-të në Albi Mall Superligë. Pjesa e parë e ndeshjes përfundoi me rezultat 0-0, derisa në minutën e 67-të, Blerim Krasniqi e shfrytëzoi një asistim të shkëlqyer të Muharrem Jasharit dhe realizoi gol për 1-0. Gjilani pati disa raste shënimi, por ishte portieri Florjan Smakiqi që e shpëtoi në disa raste skuadrën e tij që të mos pëson gol dhe të marrë pikët maksimale. Tash skuadra e Dritës është në vendin e dytë me 31 pikë, kurse Gjilani zë vendin e tetë me 17 pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të dielën, Feronikeli 74 e mposhti

Dukagjinin me rezultat 1-0, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi". Florent Avdyli ishte protagonist i kësaj fitoreje, duke shënuar një gol të bukur në minutën e 34-t. Feronikeli renditet në vendin e shtatë në tabelë me 18 pikë, kurse Dukagjini mbetet në vendin e gjashtë me 21 pikë. Të shtunën Llapi e ka ndërprerë serinë e fitoreve të Ballkanit, pasi e mposhti me rezultat 5-3, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti". Hamdi Namani dhe Muhamet Hyseni e çuan Llapin në epërsi të dyfishtë me golat e shënuar në minutat 7-të e 16-të, por Ballkani u kthye me gola nga Nazmi Gripshi (26'-pen) dhe Albin Berisha (40'). Megjithatë, golat e dytë të Namanit (45'+1') dhe Hysenit (73'-pen) si dhe goli i zëvendësuesit Ahmed



Januzi (89'), e siguruan fitoren e rëndësishme për Llapin, duke ia shkaktuar njëherësh humbjen e parë Ballkanit në këtë edicion. Krejt në fund të ndeshjes Albin Berisha shënoi për Ballkanin, por goli i tij vletë vetëm sa për statistikë, pasi ishte vonë për të ndryshuar rrjedhën e lojës. Ndërkohë, Malisheva ka siguruar një

fitore të vështirë kundër Lirisë (1-0), derisa golin e vetëm e shënoi në minutën e katërt shtesë Drilon Hazrollaj nga penalltia. Me të njëjtin rezultat ka fituar edhe Prishtina në përballje me Fushë Kosovën. Ishte kapiteni Mërgim Pefqeli, ai, i cili shënoi golin vendimtar në minutën e 32-të me një gjuajtje të fuqishme. Fushë

Kosova pati mundësi të barazonte shifrat në minutën e 76-të, por Urim Statovci dështoi të shënojë nga penalltia.

SUPERLIGA

Gjilani - Drita	0-1
Feronikeli 74 - Dukagjini	1-0
Malisheva - Liria	1-0
Prishtina - Fushë Kosova	1-0
Llapi - Ballkani	5-3

Tabela

	Pikë
1. Ballkani	15 38
2. Drita	16 31
3. Llapi	17 31
4. Malisheva	17 26
5. Prishtina	17 25
6. Dukagjini	17 21
7. Feronikeli 74	17 18
8. Gjilani	16 17
9. Fushë Kosovë	17 10
10. Liria	17 9

Trepçën mposhti Prizreni, Peja deklasoi Istogun

Trepça ka shënuar fitore ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 104:76 (22:17, 20:21, 22:25, 40:13). Takimi u vendos në dhjetë minutat e fundit, ndërsa ishte i vlefshëm për javën e 12-të të Prince Caffè Superligës. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, por në fund të kësaj pjese, vendasit me seri prej 8:0, rikthyen epërsinë në të mirë të tyre, duke e fituar këtë pjesë 22:17. Edhe periudha e dytë ishte e barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputje, ku pjesa e parë përfundon 42:38. Ngjashëm ishte



edhe periuda e tretë, ku prizrenasit nuk linin shkëputjen nga vendasit, ku shifrat pas 30 minutash ishin 64:63. Por në dhjetë minutat e fundit dhe vendimtare, mitrovicasit ishin bindshëm më të mirë, ndërsa

mysafirët assesi të këndelleshin dhe të gjenin lojën e tyre, ndërsa rezultati përfundimtar ishte 104:76 për 'Xehetarët'. Më të mirët te vendasit ishin Drilon Hajrizi me 22 pikë, 13 kërcime e gjashtë asistime, Darnell Edge me 24 pikë, pesë kërcime e shtatë asistime dhe Dardan Kapiti me 16 pikë e tetë kërcime, kurse te mysafirët më i miri ishte Arti Hajdari me 25 pikë e katër kërcime. Trepça është në vendin e parë me dhjetë fitore e dy humbje, kurse Proton Cable Prizreni numëron katër fitore e tetë humbje. Peja pa shumë

problem ka shënuar fitore kundër Istogut me rezultat 63:113 (18:25, 21:26, 13:29, 11:33). Përballja u zhvillua në kuadër të javës së 12-të të Prince Caffè Superligës. Verdhezinjët e nisën ndeshjen më mirë dhe që në fillim krijuan epërsi të dyfishtë, 10:20, derisa çerekun e parë e fituan 18:25. Pejanët vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, duke e kontrolluar ndeshje, për të shkuar në pushim me shifrat 39:51. Kampionët e Kosovës e thelluan edhe më shumë në periodën e tretë, si dhe në dhjetë minutat e

fundit, për të triumfuar në fund 63:113. Te Istogu u dalluan Tyres Prince me 19 pikë e 12 kërcime dhe Desmond Holloway me 24 pikë e pesë kërcime, kurse te Peja më të mirët ishin Justin Davis me 29 pikë, nëntë kërcime e pesë asistime, Meriton Ismaili me 20 pikë, Jay Jay Chandler me 15 pikë, 13 kërcime e nëntë asistime dhe Albin Berisha me 11 pikë, tetë kërcime e gjashtë asistime. Istogu mbetet në vendin e fundit me një fitore e dhjetë humbje, kurse kampionët e Kosovës kanë nëntë fitore e tri humbje.

KH Kastrioti nuk lejon befasi, mposhti Vëllaznimin në Gjakovë

Gjakovë, 10 dhjetor - KH Kastrioti i Ferizajt nuk ka lejuar befasi të dielën në kuadër të xhiros së 13-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Skuadra ferizajase fitoi ndaj Vëllaznimit në Gjakovë me rezultat 46:25. Pas pjesës së parë epërsia e Kastriotit ishte gjashtë gola, 18:12. Alecsander Santos i shënoi 11 gola për Kastriotin, derisa shtatë i kishte Endrit Tafarshiku. Te Vëllaznimi, Ardi

Halili i realizoi shtatë gola. Pesë i kishte Egzon Lluka. Kastrioti është i katërti me 16 pikë. Vëllaznimi është i fundit me vetëm dy pikë. Ndërsa Rahoveci ka vazhduar dominimin në Superligën e Kosovës në hendboll. Të shtunën në palestrën "Minatori" në Mitrovicë, Rahoveci e mposhti Trepçën me rezultat 42:36. Ishte kjo kryendeshja e xhiros së 13-të. Për Rahovecin ishte fitorja e 13-të,



që dëshmon për dominimin e plotë të kësaj skuadre. Rahovecasit kanë dominuar gjatë tërë ndeshjes. Herët u shkëputën

në rezultat dhe mbajtën epërsi bindëse deri në fund. Me lojë të shpejtë dhe mbrojtje të fortë e të lëvizshme, "vreshtarët" arritën te fitorja bindëse. Rahoveci udhëheq në tabelë me 26 pikë. Trepça mbetet e treta me 18 pikë. Jon Muqolli udhëhoqi Rahovecin me plot 14 gola. 12 i shënoi Alban Haziri, ndërsa 9 i kishte Mali Luzha. Te Trepça më efikasit ishin Amar Mujka e Ermir Smaka me nga 7 gola. Të shtunën u luajtën

edhe dy ndeshje të xhiros së 13-të. Kampionia në fuqi, Besa Famgas e mposhti Prishtinën me rezultat 39:30. Besa është e dyta me 20 pikë. Prishtina e pesta me 14 pikë. Antonio Vozila i shënoi 11 gola për Besën, ndërsa Ajdin Smajlbegović i kishte 7. Vladyslav Napadailo realizoi 13 gola për Prishtinën. 9 i kishte Albi Gjuka. Ndërkohë Deçani e mposhti Vushtrrinë me rezultat 36:34. Deçani është i gjashti me 6 pikë.

Genc Nuza do të ndajë drejtësinë në ndeshjen Dortmund - PSG në UEFA Youth League

PRISHTINË, 10 DHJETOR - Në një tjetër shenjë besimi ndaj gjyqtarëve kosovarë vjen nga UEFA, e cila ka deleguar Genc Nuzën si gjyqtar kryesor për ndeshjen e rëndësishme në Grupin F të UEFA Youth League. Ndeshja e planifikuar të

zhvillohet më 13 dhjetor, në orën 16:00 në "BVB Trainingszentrum", do të sjellë përballjen ndërmjet dy ekipeve të njohura, Borussia Dortmund U19 dhe Paris Saint-Germain U19. Gjyqtarët nga Kosova, Genc Nuza si gjyqtar kryesor, Edmond Zeqiri dhe

Fatmir Sekiraqa si gjyqtarë ndihmues dhe Patrick Schwengers nga Gjermania si gjyqtar i katërt, do të bëjnë ndarjen e drejtësisë në këtë ndeshje. Kjo ndeshje është mjaft interesante për faktin se do të jetë

përcaktuese se cila prej këtyre dy skuadrave do të kalojë në 1/8 e finales. Delegimi i gjyqtarëve kosovarë në ndeshjet si kjo dëshmojnë rritjen e besueshmërisë dhe të nivelit të ndarjes së drejtësisë në futbollin e Kosovës.





Kompania Rajonale e Ujësjesit
"Mitrovica" SH.A.
"Rr. Liqeni", p.n. 40000 Mitrovicë-Suhodoll



Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji Nr. 03/L-087), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit të KRU "Mitrovica" Sh.A., me seli në Mitrovicë-Suhodoll, në mbledhjen e mbajtur me datë 01.12.2023, vendosi të shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i punës : Zyrtar Kryesor Financiar

Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Ndërmarrja: Kompania Rajonale Ujësjesit, Mitrovica, Sh.A.

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Mitrovica" Sh. A, Mitrovicë

Mandati: 3 vite- me mundësi vazhdimi

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (k) dhe (l) dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. **Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:**

- Të ketë diplomë universitare të Fakultetit Ekonomik ose ekuivalente dhe përvojë të konsiderueshme nga fusha e financave dhe/ose kontabilitet.
- Diplomata nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim të dëshmuar në financa dhe/ose kontabilitet;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime,
- Njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) do të jenë përparësi;

Funksioni dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtarit Kryesor Financiar të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Zyrtari Kryesor Financiar i Shoqërisë ("ZKF") do të menaxhojë, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të Shoqërisë, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Këshilli i Drejtorëve- do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për Shoqërinë, dhe do të jetë përgjegjës që:

Të mirëmbajë llogaritë e Shoqërisë të azhuruara dhe të sakta;

Të themelojë dhe udhëhojë të gjitha kontrollat e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme, dhe pasuritë themelore. Të monitoroj llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale. Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Shoqërisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;

Të përgatisë të dhënet e Shoqërisë për auditim në fund të vitit;

Të rishikoj, të arrij marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikat e sigurimit;

Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve, si dhe të bëjë blerje me KE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të Shoqërisë;

Menaxhojë thesarin e Shoqërisë;

Të vendos dhe përgatitë buxhetet; dhe

Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

Detyrat dhe përgjegjësitë e ZKF-së janë:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të kompanisë në regjionin që e mbulon kompania.
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me: Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin i Auditimit, Kryeshefit Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Departamenteve,
- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikojë buxhetin, të vëzhgojë mospërputhjet. Të përcjellë regjistrimin në kontabilitet, të japë këshilla të gjithë personelit të sektorëve për veprime efektive. Të vëzhgojë-përcjell qarkullimin e parasë së gatshme dhe transaksionet bankare,
- Përmes Menaxherit Ekzekutiv dhe personelit tjetër, të udhëhojë me ndërmarrjen përpara palëve të interesit (Bordi i Drejtorëve-Aksionari, Komuna, Donatorët). Të sigurojë llogari sipas nevojës që kërkohen për raportimin e ndërmarrjes,
- Përmes personelit nënrenditës, posaçërisht menaxherit ekzekutiv të shitjes, dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxherin ekzekutiv të shërbimit të konsumatorëve, të udhëhojë dhe kontrollojë të hyrat nga: Faturimi dhe inkasimi; mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve,

- Të këshillojë përmes Kryeshefit Ekzekutiv në Bordin e Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të ndërmarrjes, planet e tanishme të biznesit dhe planet periodike dhe afat gjatë të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve,
- ZKF-zotëron planin e aktivitetit të Kompanisë të specifikuar në çdo Plan të Biznesit,
- Kërkon, propozon, gjen dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së kompanisë,
- Udhëhojë personelin nënrenditës për të siguruar shërbime efektive,
- Vazhdimisht kërkon metoda dhe mënyra për të ndërruar dhe përmirësuar qasjen ndaj punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve,
- Për punën që kryen i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Paga: Në pajtim me „Rregulloren për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së „ të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacioni duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diplomat nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmitë e eksperiencës në punë / referencat (duke pasur të shënuar email-adresat dhe numrat kontaktues),
- Certifikatat (nëse posedon) lidhur me njohurit në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sipas udhëzimeve të Federatës ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

Aplikacioni dhe Deklarata nën Betim mund të merren në ueb-faqen e Kompanisë në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>. Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të skanuara ose në formatin .pdf në email adresën: rekrutimi@kru-mitrovica.com.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit duke filluar nga data 11.12.2023 deri me datën 09.01.2024.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Kompanija Regionalnog Vodovoda
"Mitrovica" D.O.,
"Ul." Jezero ", b.b. 40000 Mitrovica-Suvi Do

U skladu sa funkcijama i ovlašćenjima prdviđenim Članom 21 u vezi sa članom 17 Zakona o Javnim Preduzećima (Zakon Br. 03/L-087), izmenjen i dopunjen Zakonom Br.04/L-111 i Zakonom br. 05/L-009) za Zakona o Javnim Preduzećima, Upravni Odbor i Komisije za Reviziju KRV "Mitrovica" D.O., sa sedištem u Mitrovici-Suvi Do, na sednici održanoj dana 01.12.2023 godine, odlučio da raspiše ovaj:

JAVNI KONKURS

Radno Mesto : Glavni Financijski Zvaničnik

Mesto: Mitrovica-Suvi Do

Preduzeće: Kompanija Regionalni Vodovod., Mitrovica., D.D.

On Odgovara: Upravnom Odboru i Izvršnom Direktor KRV „Mitrovica“ D.D. Mitrovica.

Mandat: 3 godine – sa mogućnošću produženja

Uslovi i zahtevane kvalifikacije:

Upravni Odbor želi da se obezbedi da svi potencijalni kandidati budu lica sa poznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacija prema članu 17.1., ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2. tačka (d), (f), (k) i (l) i imaku potrebno stručno iskustvo i zahtevano školovanje za navedenu poziciju.

Osim ovih opštih uslova, kandidati treba da ispunjavaju i ove posebne uslove:

- Da ima Univerzitetsku diplomu Ekonomskog Fakulteta ili ekuivalent i značajno iskustvo u oblasti i/ili računovodstva.
- Diplome od stranih univerziteta teba da budu nostifikovane od strane Ministarstva prosvete, Nauke i Tehnologije;
- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva u dokaznom menadžmentu i/ili računovodstvu;
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet,
- Da ima dokazne sposobnosto upravljanja,
- Poznavanje stranih jezika je prednost,
- Da ne bude osuđen ili pod istragom,
- Znanje u tumačenju Međunarodnih Računovodstveni Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finansijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovoda (MFR) će biti prioritet;

Funkcionisanje i glavne odgovornosti Glavnog Financijskog Zvaničnika određene Statutom Kompanije:

Glavni Financijski Zvaničnik Društva (GFZ) će upravljati pod upravom i nadzorom IO, finansijske poslove društva, podležu graničenjima koja nameće Upravni odbor – imat će autoritet veze svih finansijskih ugovora za Društvo, i bit će odgovoran da:

Da održava račune Kompanije ažurnim i tačnim.

Da uspostavi i upravlja svim internim finansijsim kontrolama, uključujući nabavke, gotovinskog novca i osnovna sredstva. Da prati dugovanja i koordinira plaćanje računha i posebne kupovine. Da pregleda troškove zaposlenih kako bi se osigurala uskladenost sa politikama kompanije i njihovim budetom pre njihovih isplata.

Da pripremi podatke Kompanije za reviziju na kraju godine;

Da preispita postizanje sporazuma za nabavku i održavanje shih poslova vezanih sa politikama obezbeđenja;

Da koordinira ostale funkcije poslovanja, kao što su izdavanje objekata i opreme pod zakum, kao i da vrši kupovinu za EK i kancelarijom ili funkcijom nabavke kompanije.

Da menadžita trezorom Kompanije;

Da odlučuje i pripremi budete, i

I bilo koji drugi zadatak koji odredi EK.

Zadaci i odgovornosti GFZ su:

- Odgovara za sve finansijske postuake kompanije u rgiji koju pokriva kompania.
- Obavezuje se za usku saradnju sa: Upravni Odbor i Komisije za Reviziju, Izvršnim Direktorom, Komercijalnim Direktorom, Tehničkim Direktorom i sa rukovodiocima odelenja.
- ma za zadatak da izradi i planira budžet, da prato neslaganja . Da prati registraciju u računovodstvu, da daje savete čitavom osoblju sektora za efektivne postuake. Da prati promet gotovog noca i bankarskih transakcija.
- Preko Izvršnog Direktora o ostalog osoblja, da rukovodi sa preduzećem pred stranama interesa (Bord Direktora-Akcionari, Opština, Donatori). Da obezbedi rakun po potrebi koji se zahtevaju za izveštavanje preduzeća.
- Preko podređenog osoblja, posebno izvršnog direktora prodaje, i u uskoj saradnji sa izvršnim direktorom usluga potrošača, da rukovodi i kontroliše prihode od: Fakturisanja i inkasiranja, odražavanje podataka potrošača.
- Da savetuje preko Glavnog Izvršnog Direktora u Upravnom Odboru, u vezi sa finansijskim progresom preduzeća, sadašnje planove poslovanja i periodične i dugoročne planove trokova i aktivnosti, tok prihoda i rashoda.
- GFZ-poseduje poslovni plan Kompanije specifikovane u vaki Plan
- Zahteva, predlaže, namazi i sprovodi metode i načine za promenu i popravku metoda rada sa namerom poboljšanja usluga potrošača.
- Obezbeđuje da svo osoblje bude informisano sa namerama i zajedničkom misijom odelenj, odnosno celine kompanije,
- Vodi podređeno osoblje kako bi osigurali efikasne usluge,

- Stalno traži metode i načine da prometi i popravi pristup prema radu sa namerom popravljanja usluga potrošača.,
- Za obavljene posao odgovara Upravnom Odboru i Glavnom izvršnom Direktor.

Plata: U skladu sa "Pravilnikom o raspodeli ličnih primarja KRVM" usvojeno od strane Upravnog Odbora. .

Procedura aplikacije:

Aplikaciji treba priložiti i sledeća dokumenta:

- CV-ja (Biografija),
- Kopija lisne karte,
- Motivaciono pismo,
- Izjava pod zakletvom,
- Univerzitetska Diploma (notarizovana kopija, dok diplome sa univerziteta van zemlje treba da budu nostrifikovane),
- Dokaz od i nadležnog suda da nije pod istragom, ne starija od 6 meseci,
- Dokazi o stručnoj spremi,
- Dokazi o radnom iskustvu/ reference (navodeći imejl adrese i kontakt brojeve)
- Sertifikati (ukoliko ih poseduje) u vezi sa Znanjem u tumačenju Međunarodnih Računovodstvenih Standarda (MRS) i Međunarodnih Standarda Finansijskog Izveštavanja (MSFI), prema uputstvima Međunarodne Federacije Računovoda (MFR) će biti prioritet;

Aplikacije mogu da se uzmu u direkciji Kompanije (ili veb-stranici Kompanije) na adresi : <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>. Aplikacija i prateća dokumenta treba da se predaju skenirano ili u .pdf formatu na mejl adresu: rekrutimi@kru-mitrovica.com

Konkurs će biti ovoren 30 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja pecevsi od dana 11.12.2023 do 09.01.2024.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju..

KRV "Mitrovica" D.D. Mitrovic-Suvi Do



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sabahate Byci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

Naim Memaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Sitki Shefqeti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "28 Nëntori" Brodosan Dragash.

Qendrim Kabashaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Sadri Thaqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Zef Lush Marku" Velezhe.

Milica Mitic shpall te pavlefshme dëftesat e kl I,II,III,IV dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

Arbenit Sadiku shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Dr. Valon Hyseni me numër të licencës: KO-05171-01-22, shpall të pavlefshme vulën.

Dr. Ditor Haliti me numër të licencës: KO-03372-01-22, shpall të pavlefshme vulën.

Dr. Arsim Gërxfhaliu me numër të licencës: KO-01376-01-22, shpall të pavlefshme vulën.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

